

RAPORT I MONITORIMIT

**ZBATIMI I STRATEGJISË QEVERITARE PËR BASHKËPUNIM ME
SHOQËRINË CIVILE PËR PERIUDHËN 2013-2016**

KËNDVËSHTRIM I SEKRETARIATIT TË CIVIKOS

Prishtinë, 2016

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
II. HISTORIKU I BASHKËPUNIMI TË FORMALIZUAR NË MES TË SHOQËRISË CIVILE DHE QEVERISË	3
III. STRATEGJIA QEVERTARE PËR BASHKËPUNIM ME SHOQËRINË CIVILE 2013-2017	4
Përmbajtja e Strategjisë Qeveritare.....	4
IV. ZBATIMI I STRATEGJISË QEVERTARE.....	6
Themelimi dhe funksionalizimi i trupave të zbatimit	6
Monitorimi dhe Raportimi i Strategjisë Qeveritare	6
Të arriturat e Strategjisë Qeveritare.....	6
V. DISA NGA SFIDAT E PËRGJITHSHME NË ZBATIM TË STRATEGJISË QEVERTARE.....	7
VI. ZBATIMI I STRATEGJISË QEVERTARE PËR KATËR OBJEKTIVAT STRATEGJIKE	13
VII. SHTOJCAT	17

Autor: Dardan Kryeziu

Zyrtar për Monitorim, Vlerësim dhe Raportim

Sekretariati i Platformës CiviKos

Prishtinë 2016

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Edhe pse Strategjia Qeveritare për Bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017 (më tutje do t'i referohemi si Strategjia Qeveritare) është hartuar për periudhën 2013-2017, zbatimi i kësaj Strategjie ka filluar me vonesë. Vendimi për aprovimin e Strategjisë Qeveritare është marrë me 5 Korrik 2013, ndërsa vendimi për themelimin e Këshillit për zbatim të Strategjisë është marrë me një vit vonesë, respektivisht me 2 Prill 2014. Vetëm në Tetor 2014 është funksionalizuar Këshilli dhe janë themeluar grupet e punës për katër objektivat strategjike që dalin nga ky Këshill. Përzgjedhja e anëtarëve të shoqërisë civile është bërë me një proces të hapur dhe demokratik, derisa shoqëria civile ka një anëtar më tepër në Këshill. Është aprovuar Rregullorja për Standardet Minimale për procesin e konsultimit publik, e cila Rregullore bazën e ka tek dokumenti i përgatitur nga organizata KCSF, ku përmes Këshillit i është dorëzuar zyrtarisht Zyrës së Kryeministrit. Hartimi i rregullores është bërë me një pjesëmarrje të gjerë të shoqërisë civile, me përkrahje të Zyrës Ligjore nga Zyra e Kryeministrit dhe donatorëve të jashtëm. Po ashtu është përcaktuar modeli i financimit publik për OSHC-të, si dhe ka filluar hartimi i Rregullores për Ndarjen e Fondeve Publike për OSHC. Certifikata e OJQ-ve pranohet në procesin e prokurimit publik, si dhe janë duke u zhvilluar disa analiza sa i përket kontraktimit të shërbimeve dhe vullnetarizmit në Kosovë. Këshilli dhe grupet e punës kanë zhvilluar takime të rregullta me lehtësimin e ZQM-së, dhe Sekretariatit të CiviKos. Përveç raporteve të rregullta që ZQM përgatit rreth implementimit të Strategjisë, Sekretariati i CiviKos paralelisht monitoron zbatimin e Strategjisë Qeveritare dhe në mënyrë periodike përgatit raporte.

Ky raport është një përmbledhje e monitorimit të zbatimit të Strategjisë Qeveritare i përgatitur nga Sekretariati i Platformës CiviKos duke u bazuar në monitorimin paralel që Sekretariati realizon. Qëllimi i këtij raporti është ofrimi i një pasqyre të zbatimit të Strategjisë Qeveritare nga perspektiva e shoqërisë civile, identifikimin dhe adresimin e sfidave në gjithë procesin e bashkëpunimit shoqëri civile-qeveri, si dhe nxjerrjen e rekomandimeve konkrete që do të ndihmonte në zbatim të Strategjisë Qeveritare. Përveç kontributit në përmirësimin e zbatimit të kësaj Strategjie në periudhën e mbetur, ky raport synon të nxjerrë edhe mësimet kryesore nga ky proces të cilat do të duhej të adresoheshin gjatë hartimit të strategjisë së ardhshme për bashkëpunim në mes të qeverisë dhe shoqërisë civile.

Ky raport nuk është raport zyrtar i zbatimit të Strategjisë Qeveritare por është një raport përmbledhës i monitorimit të Strategjisë nga Sekretariati i CiviKos i konsultuar edhe me koordinatorët e ekipeve të punës së Këshillit nga shoqëria civile.

II. HISTORIKU I BASHKËPUNIMIT TË FORMALIZUAR NË MES TË SHOQËRISË CIVILE DHE QEVERISË

Një grup i organizatave të shoqërisë civile kishin marrë iniciativën për të filluar bashkëpunimin formal në mes të institucioneve të Kosovës dhe shoqërisë civile. Zyra e Kryeministrit të Kosovës me Kryeministër Agim Çeku dhe organizatat e shoqërisë civile që kishin themeluar organizatën Platforma CiviKos në Nëntor të vitit 2007, kishin nënshkruar marrëveshjen e parë për bashkëpunim në mes të shoqërisë civile dhe Qeverisë së Kosovës. Ky proces është edhe si hapi i parë i një përpjekjeje për të formalizuar marrëdhënien shoqëri civile-qeveri. Ishte një përkushtim i të dy palëve për të koordinuar veprimet e

tyre, në përmirësimin e qeverisjes, zhvillimin e demokracisë dhe forcimin e rolit të shoqërisë civile në vendimmarrje.

Pas shpalljes së Pavarësisë në vitin 2008, me ndryshimin e sistemit të qeverisjes dhe ndërtimit të institucioneve të Republikës së Kosovës, shoqëria civile dhe institucionet e qeverisë ende nuk kishin marrë ndonjë hap konkret në formalizimin e marrëdhënieve në mes vete. Në vitin 2012 Platforma CiviKos së bashku me Zyrën për Qeverisje të Mirë të Zyrës së Kryeministrit (ZQM-ZKM) filluan procesin e hartimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017. Pas një pune të madhe nga ekspertë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe institucioneve të Kosovës, dhe pas një konsultimi të gjerë me organizata të shoqërisë civile nga të gjitha rajonet e Kosovës, u hartua Strategjia Qeveritare. Aprovimi i Strategjisë Qeveritare dhe themelimi i Këshillit janë hapat e parë të formalizimit të këtij bashkëpunimi qysh pas shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës.

III. STRATEGJIA QEVERTARE PËR BASHKËPUNIM ME SHOQËRINË CIVILE 2013-2017

Përmbajtja e Strategjisë Qeveritare

Katër objektivat strategjike të Strategjisë Qeveritare, për Bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017 janë:

- **Objektivi Strategjik 1: Pjesëmarrje e siguar dhe e fuqizuar e shoqërisë civile në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit** - Me anë të kësaj objektivë synohet të avancohet baza e legjislacionit për fuqizimin e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në hartimin, dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit. Hartimi dhe përcaktimi i Standardeve Minimale për procesin e konsultimit publik, ku shoqëria civile, dhe publiku i gjerë do të përfshihej në procesin e konsultimit publik qysh në fazat e para të hartimit të dokumenteve qeveritare, është ndër bazat e këtij objektivë Strategjik.

- **Objektivi Strategjik 2: Sistem i ndërtuar i kontraktimit të shërbimeve publike për organizatat e shoqërisë civile** - Organizatat e shoqërisë civile në Kosovë janë duke vazhduar të japin një numër të madh të shërbimeve që nuk mbulohen nga institucionet shtetërore fare, ose këto shërbime i janë deleguar organizatave të shoqërisë civile. Kryesisht në Kosovë organizatat e shoqërisë civile japin shërbime në fushat sociale si shërbime për personat me nevoja të veçanta, shërbime për gratë viktime të dhunës në familje, për fëmijët jetim etj. Po ashtu ka një numër të madh të organizatave që japin shërbime në fushën e arsimit, shëndetësisë, drejtësisë etj. Nuk dihet saktësisht lloji i shërbimeve që organizatat kontraktohen nga qeveria. Në kuadër të kësaj objektivë është paraparë të krijohet një sistem i qëndrueshëm dhe i pavarur i kontraktimit të shërbimeve për OCHC-të nga ana e qeverisë.

- **Objektivi Strategjik 3: Sistem i ndërtuar dhe kritere të përcaktuara për përkrahje financiare për OshC** - Edhe pse një pjesë e madhe e punës së organizatave zhvillohet në mënyrë vullnetare, organizatat e shoqërisë civile për të zbatuar aktivitetet e tyre kanë nevojë për fonde. Puna e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë kryesisht varet nga fondet e huaja, Qeveria e Kosovës megjithatë ndanë fonde në mënyrë të vazhdueshme për projekte që zbatohen nga OSHC-të në Kosovë. Kjo objektivë

strategjike ka për synim krijimin e një sistemi transparent të përkrahjes financiare për shoqërinë civile nga fondet publike, me mekanizma të qartë të raportimit dhe mbikëqyrjes.

• **Objektivi Strategjik 4: Nxitja e qasjes së integruar në zhvillimin e vullnetarizmit** - Vullnetarizmi aktualisht është një fushë e nën-rregulluar me legjislacionin dhe politikat shtetërore të Kosovës. Ligji për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë trajton në mënyrë të përgjithshme vullnetarizmin tek të rinjtë duke u kufizuar në moshën 15-24 vjeç. Duke marrë parasysh diversitetin shoqëror kjo objektivë strategjike synon që fillimisht të analizohet, dhe të identifikohen nevojat dhe profili i punës vullnetare në Kosovë. Varësisht nga të gjeturat ë zhvillohet debati dhe ndërtohet sistemi më adekuat për vullnetarizëm duke u bazuar në nevojat specifike të Kosovës.

Trupat për Zbatim të Strategjisë Qeveritare

Këshilli - Këshilli është struktura kryesore përgjegjëse për sigurimin e zbatimit të Strategjisë Qeveritare. Në kuadër të Këshillit janë themeluar edhe katër grupe të punës për katër objektivat strategjike. Grupet punuese janë themeluar me qëllim të rritjes së dinamikës së punës tematike, pa pasur nevojë të angazhimit të vazhdueshëm të gjithë Këshillit në baza të vazhdueshme.

Anëtarët e Këshillit nga Qeveria - Këshilli në përbërjen e tij ka 25 anëtarë, nga të cilët 14 përfaqësues janë nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Nga 14 anëtarë të Qeverisë, 6 janë drejtorë të zyrave përkatëse të Zyrës së Kryeministrit dhe 7 janë Sekretarë të Përgjithshëm të Ministrive, me kryesues Sekretarin e Përgjithshëm nga Zyra e Kryeministrit.

Anëtarët e Këshillit nga shoqëria civile - Shoqëria civile ka 15 përfaqësues në Këshill, ku 14 janë zgjedhur me procedurë të hapur dhe demokratike nga Platforma CiviKos, dhe një është emëruar drejtpërdrejt nga Platforma CiviKos me vendim.

Mënyra e Punës së Këshillit- Këshilli për Zbatimin e Strategjisë Qeveritare si struktura përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë ka për obligim të organizoj takime së paku katër herë në vit. ZQM si Sekretariat i Këshillit është përgjegjëse në thirrjen e seancave të Këshillit në bashkëpunim me anëtarët e Këshillit. Në Këshill kryesisht diskutohen të arriturat dhe sfidat në zbatim të Strategjisë, propozohen masa shtesë, sipas nevojës. Vendimet kryesisht merren me konsensus. Në rast të mungesës së konsensusit vendimet hidhen në votim.

Grupet e Punës së Këshillit - Në kuadër të Këshillit janë themeluar edhe katër grupe punuese sipas katër objektivave strategjike. Koordinatorët e grupeve të punës janë përzgjedhur me konsensus, ku tre nga koordinatorët janë nga shoqëria civile dhe një nga qeveria. Grupet e punës mbajnë takime më shpesh se Këshilli. Puna kryesore zhvillohet dhe diskutohet në grupe punuese. ZQM në bashkëpunim me koordinatorët fton takimet e grupeve punuese varësisht nga nevoja.

IV. ZBATIMI I STRATEGJISË QEVERTARE

Themelimi dhe funksionalizimi i trupave të zbatimit - Për të siguruar zbatimin e Strategjisë Qeveritare është themeluar Këshilli për Zbatimin e Strategjisë Qeveritare dhe katër grupet punuese sipas katër objektivave strategjike. ZQM është përcaktuar si sekretariat i Këshillit. Këshilli dhe grupet punuese kanë mbajtur takime të rregullta qysh nga themelimi. Përbërja e Këshillit ka ndjekur modelin e përfaqësimit +1 në favor të shoqërisë civile, në kuptimin që nga të gjithë anëtarët e Këshillit, gjithmonë shoqëria civile të ketë një anëtar më shumë sesa Qeveria. Kjo për të mundësuar një rol më të rëndësishëm të shoqërisë civile në këtë Këshill, të paktën në aspektin e përfaqësimit.

Monitorimi dhe Raportimi i Strategjisë Qeveritare - ZQM sipas mandatit ka për obligim përgatitjen e raporteve rreth zbatimit të Strategjisë Qeveritare, ndërsa Këshilli ndihmon dhe këshillon ZQM-në për përgatitjet e raporteve. Me ndihmën e GIZ, ZQM ka përgatitur një matricë të monitorimit që lehtëson grumbullimin e informatave.

Të arriturat e Strategjisë Qeveritare- Rregullorja për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik si pjesë e objektivës së parë strategjike, është aprovuar në Prill të vitit 2016. Kjo Rregullore është bazuar tek dokumenti i përgatitur nga organizata KCSF, ku përmes Këshillit i është dorëzuar Zyrës së Kryeministrit. Rregullorja është hartuar me një pjesëmarrje të gjerë të shoqërisë civile dhe akterëve tjerë. Pas miratimit të Rregullores, kanë filluar edhe trajnimet për nëpunës civilë rreth përdorimit të Rregullores. Po ashtu është marrë në pronësi të ZQM-së platforma online e mbështetur nga projekti i asistencës teknike të BE-së, e cila Platformë do të jetë mjeti kryesor i organizimit të konsultimit publik.

Lejimi i certifikatës së OJQ-së si dokument i pranueshëm në procesin e prokurimit publik është ndër arritjet e vetme në objektivën e kontraktimit të shërbimeve. Ky avancim ka ndodhur gjatë plotësimit të Ligjit për Prokurim Publik, pas kërkesës zyrtare të shoqërisë civile.


Sa i përket fondeve publike për organizatat e shoqërisë civile, në kuadër të objektivës së tretë është përcaktuar modeli i decentralizuar i financimit publik për OSHC-të, si dhe ka filluar hartimi i Rregullores mbi Standardet Minimale, dhe Procedurat për Shpërndarjen e Fondeve Publike.

Sekretariati i Platformës CiviKos në bashkëpunim me Ministrinë e Integritetit dhe ZQM kanë organizuar trajnime për organizatat e shoqërisë civile në hapjen e Platformës për Menaxhim të Ndihmave Zhvillimore (AidManagement) e cila platformë tani është e qasshme nga organizatat e shoqërisë civile.

Sipas raportit zyrtar rreth zbatimit të Strategjisë Qeveritare, përgatitur nga ZQM, në bashkëpunim me koordinatoret e ekipeve të punës, Strategjia Qeveritare, respektivisht Plani i Punës për vitin 2015 është zbatuar 40.03 %. Ndërsa sipas objektivave del që Objektiva e I-rë është realizuar 31.8 %, Objektiva II-të 42.9 %, Objektiva III-të 45.05 %, dhe Objektiva e IV-të 50 %¹.

¹ <https://zqm.rks-gov.net/Portals/0/RAPORTI%20-%20I%20FUNDIT%20%20JANAR%20%202016.pdf>

Sipas një vlerësimi të Planit të veprimit të Strategjisë për vitin 2013-2016 nga ana e Sekretariatit të Civikos, , niveli i zbatimit të Strategjisë sipas objektivave deri më tani është: Objektiva e parë është zbatuar 70.83 %, Objektiva e dytë 29.16 %, Objektiva e tretë 41.17 %, dhe objektiva e katërt 33.33 %.



V. DISA NGA SFIDAT E PËRGJITHSHME NË ZBATIM TË STRATEGJISË QEVERTARE

Vonesa fillestare në fillim të zbatimit të Strategjisë -Edhe pse Strategjia Qeveritare është hartuar për periudhën 2013-2017, zbatimi i kësaj Strategjie ka filluar me një vit vonesë. Në Dhjetor 2014 është hartuar Plani i Veprimit për vitin 2015, ku janë bartur të gjitha aktivitetet e parapara për implementim gjatë vitit 2013-2014.

Vonesa në themelimin e Këshillit dhe Planit të Punës - Vendimi për aprovimin e Strategjisë është marrë me 5 Korrik 2013, ndërsa vendimi për themelimin e Këshillit është marrë me një vit vonesë, respektivisht me 2 Prill 2014. Vetëm në Tetor 2014 është konsoliduar Këshilli, ku edhe janë themeluar grupet e punës për çdo objektive strategjike. Plani i punës për zbatimin e Strategjisë Qeveritare është hartuar në dhjetor 2014 dhe zbatimi i këtij plani të punës ka filluar në 2015, ku dhe ka pasur shumë vonesa në zbatim të veprimeve.

Vonesa në krijimin e sistemit të monitorimit dhe raportimit - Përkundër qe është ndër strategjitë e pakta qe ka arritur të ndërtojë një sistem funksional te monitorimit e raportimit te rregullt, me qasje edhe nga shoqëria civile, ende mungon monitorimi kualitativ. ZQM si sekretariat i Këshillit në mënyrë të vazhdueshme është përpjekur në përpilimin e raporteve sa më përmbledhëse por ka pasur vështirësi në

grumbullimin e informatave nga ministrinë e linjës, duke mos pasur koordinim në përmbledhje të raporteve. Gjatë takimeve të Këshillit është adresuar në mënyrë të vazhdueshme mungesa e raporteve kualitative të zbatimit të Strategjisë nga ana e ministrive të linjës. Po ashtu raportimi shpesh herë është përcjellë me mungesë e evidencës për përfundimin e veprimeve të caktuara. Si pasojë në raportin e zbatimit të Planit të Veprimit për 2015, të prezantuar në takimin e Këshillit me 22 Dhjetor 2015, shumë veprime kanë rezultuar si të përfunduara duke ngritur nivelin e zbatimit të Strategjisë në 61.3 %. Duke mos pasur konsistencë me raportin e përgatitur nga Sekretariati i Civikos, me vendim të Këshillit, ky raport nuk miratohet. Pas rishikimit me të gjitha grupet e punës është bërë plotësim ndryshimi dhe përqindja e zbatimit ka zbritur në 40.03 %.

(Shembull) Mungesa e evidencës shpesh ka rezultuar me veprim të përfunduar. P.sh veprimi rreth analizës së legjisacionit, është deklaruar si i përfunduar mirëpo ka munguar raporti të gjeturave dhe rekomandimeve. Këshilli ka sugjeruar që vetëm raportet e analizave konfirmojnë përfundimin ose jo të një analize.

Mos ndarja e buxhetit nga Qeveria për zbatim të Strategjisë Qeveritare - Pas miratimit të Strategjisë Qeveritare, në planet e punës për vitin 2015, dhe 2016 është paraparë edhe ndarja e buxhetit nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Deri më tani Qeveria nuk ka ndarë një buxhet të veçantë për zbatim të Strategjisë Qeveritare.

Për shkak të mos-ndarjes së buxhetit nga ana e Qeverisë, shumica e veprimeve të parapara janë realizuar me mbështetje të donatorëve të jashtëm si TACSO, GIZ, FES, Komisioni Evropian etj. Po ashtu nga Prilli i vitit 2016 në mbështetje për ZQM, respektivisht zbatimit të Strategjisë Qeveritare është lansuar projekti i financuar nga BE **“Mbështetje për Zbatimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me shoqërinë civile”**, ku vetëm një pjesë e veprimeve të parapara me plan të punës për vitin 2016 do të financohen nga ky projekt.

Tab.1. Buxheti i nevojshëm, për realizimin e Strategjisë Qeveritare, dhe buxheti i ndarë nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Buxheti i paraparë me planin e veprimit 2013-2017, i aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës ka qenë 276000 euro.

Tab.2. Buxheti i nevojshëm për vitet 2015 dhe 2016 dhe buxheti i paraparë me planet e punës.

Viti	Buxheti i nevojshëm për realizim të Planit të Punës 2015 dhe 2016	Buxheti i ndarë
2015	287.000 euro	Nuk ka informata për ndarje të buxhetit përveç shpenzimeve administrative të ZQM

		dhe institucioneve tjera përgjegjëse.
2016	249.300 euro	Nuk ka informata për ndarje të buxhetit përveç shpenzimeve administrative të ZQM dhe institucioneve tjera përgjegjëse.

ZQM si Sekretariat i Këshillit dhe kapacitetet e tyre të brendshme- Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM), në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZKM) është mandatuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të shërbej si Sekretariat i Këshillit për zbatimin e Strategjisë Qeveritare. Sipas vendimit për themelimin e Këshillit, është përcaktuar që ZQM do të jetë organi përgjegjës për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të Strategjisë Qeveritare. Po ashtu ZQM sipas vendimit do të përgatis raporte të implementimit të Strategjisë, lehtësoj punën e Këshillit dhe grupeve punuese. *(Për detaje shiko në fund shtojcën nr. 2).*

Organizatat e shoqërisë civile edhe gjatë procesit të hartimit të Strategjisë, edhe pas fillimit të zbatimit të Strategjisë Qeveritare, në mënyrë të vazhdueshme kanë ngritur shqetësimin për kapacitetet e limituara të kësaj zyre në zbatim të Strategjisë. Ky shqetësim po ashtu është reflektuar edhe në raportin e progresit për vitin 2016². Nga tetë të punësuarit në këtë zyre asnjë nëpunës nuk është i emëruar vetëm për koordinim të punëve të Strategjisë Qeveritare, por një zyrtar ndër të tjera merret edhe me këtë Strategji *(Shiko shtojcën nr. 3 për përbërjen e ZQM).*

Obligimet shtesë të ZQM në implementimin e Strategjisë Qeveritare - Përveç koordinimit dhe lehtësimit të punës së Këshillit, si dhe monitorimit të zbatimit të Strategjisë, ZQM në planet e punës së Strategjisë për vitin 2015 ka qenë si institucion përgjegjës për implementimin e 38 veprimeve për katër objektivat strategjike. Në 5 prej veprimeve ZQM ka qenë institucioni i vetëm përgjegjës, dhe në 33 veprime përgjegjës së bashku me institucionet tjera. Në Planin e punës për vitin 2016 ZQM është institucion përgjegjës së bashku me institucionet tjera në 24 veprime.

Varësia e lartë në ekspertizën e ofruar nga shoqëria civile dhe ekspertët e jashtëm - Arritjet kryesore në zbatim të Strategjisë Qeveritare si hartimi i standardeve minimale për konsultim publik, përcaktimi i modelit për fondet publike, ndryshimet në ligj për prokurim publik, analizat e legjislacionit për vullnetarizëm, kontraktim të shërbimeve etj janë të bazuara në ekspertizë nga shoqëria civile dhe ekspert të jashtëm. Në përgjithësi ka munguar ekspertiza nga ana e qeverisë për trajtimin e veprimeve që lidhen me Strategjinë Qeveritare.

Pjesëmarrje e ulët e anëtarëve të Këshillit nga Qeveria në proces të zbatimit të Strategjisë Qeveritare, si dhe në hartimin e planit të veprimit për vitet 2015 dhe 2016 - Që nga konsolidimi i Këshillit pjesëmarrja e Sekretarëve dhe Drejtorëve të zyrave ka qenë shumë e ulët. Kryesisht në takimet Këshillit dhe grupeve të punës janë deleguar zyrtarë tjerë të ministrive, të cilët në shumicën e rasteve nuk kanë qenë personat e njëjtë, duke shkaktuar vështirësi në vendimmarrje dhe vazhdimësi të punës. Po ashtu në hartimin e planit të punës për vitin 2015, ka pasur mungesë të konsiderueshme të pjesëmarrësve nga

² http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/what-we-do/policies/european-agenda-migration/proposal-implementationpackage/docs/20160504/fourth_progress_report_on_kosovo_visa_liberalisation_roadmap_en.pdf

Qeveria, edhe përkundër delegimit të pikave të kontaktit pjesëmarrja ka qenë e ulët. Shpesh herë vonesat në zbatim të veprimeve të Strategjisë gjatë vitit 2015 janë arsyetuar me mos marrje të përgjegjësisë nga ana e institucioneve, pasi veprimet nuk janë vendosur në konsultim me akterët relevant të ministrive, të cilët kanë munguar në hartimin e planit të punës. Në hartimin e planit të punës për vitin 2016 me sugjerim të Sekretariatit të CiviKos, dhe në koordinim me grupet e punës dhe ZQM është lënë më shumë kohë në hartimin e planit të punës, edhe pse në disa grupe ka pasur mungesë të zyrtarëve nga ministritë relevante.

Tab 3. Pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit nga Qeveria në takime të këshillit

Takimet e Këshillit	Numri i pjesëmarrësve	Pjesëmarrja e të emëruarve në Këshill Sekretarëve	Pjesëmarrja e të deleguarve (pikat e kontaktit)
Takimi i I-rë	14	8	6
Takimi i II-të	13	5	8
Takimi i III-të	6	1	5
Takimi i IV-të	12	4	8
Takimi i V-të	7	3	4
Takimi i VI-të	10	4	6

Pjesëmarrje e ulët e anëtarëve të shoqërisë civile në zbatimin e Strategjisë - Mos funksionalizimi i grupeve të punës të Platformës CiviKos - Edhe nga ana e shoqërisë civile ka pasur mungesë të angazhimit dhe ekspertizës në zbatim të Strategjisë Qeveritare. Me Rregulloren e Punës për Zbatimin e Aktiviteteve të Platformës CiviKos, është paraparë edhe funksionimi i grupeve të punës të Platformës CiviKos të cilat grupe kryesisht kanë rol avokues. Grupet punuese të CiviKos përbëhen kryesisht nga anëtarë të shoqërisë civile. Me sugjerim të Bordit të Platformës CiviKos, dhe duke u bazuar në Rregulloren e Punës janë paraparë të formohen katër grupe punuese sipas katër objektivave strategjike të Strategjisë Qeveritare. Këto grupe do të shërbenin si trupa mbështetëse për Këshillin, duke avokuar dhe mbështetur zbatimin e Strategjisë Qeveritare. Të katër grupet janë formuar dhe mbajtur disa takime informuese, mirëpo nuk janë funksionalizuar asnjëherë për shkak të pjesëmarrjes së ulët të organizatave të shoqërisë civile.

Tab.4. Pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit nga shoqëria civile në takime të Këshillit

Takimet e Këshillit	Numri i pjesëmarrësve
Takimi i I-rë	13
Takimi i II-të	13
Takimi i III-të	9
Takimi i IV-të	9
Takimi i V-të	9
Takimi i VI-të	8

Mungesa e përcjelljes sistematike të obligimeve të Strategjisë nga institucionet përkatëse- Kryesisht ka pasur vonesa në zbatim të veprimeve të Strategjisë sa i përket afateve kohore të vendosura bashkërisht, si dhe mungesë të cilësisë në zbatim dhe raportim.

Shembull: Mos publikimi fondeve qeveritare të ndara për shoqëri civile - Qysh nga themelimi i Këshillit, anëtarët nga shoqëria civile në mënyrë të vazhdueshme kanë kërkuar nga Qeveria e Kosovës që të publikojnë fondet qeveritare që ndahen për organizata të shoqërisë civile. Publikimi i fondeve do të rriste transparencën, dhe do të kishim një pasqyrë të qartë të ndarjes së fondeve qeveritare për shoqëri civile. Sekretariati i Platformës CiviKos me 17 Shtator 2015 ka organizuar një tryezë në Qendrën Kulturore dhe Informativë të BE-së ku është ritheksuar mungesa e transparencës në ndarjen e fondeve publike për shoqërinë civile. Në Maj 2016 është dërguar një kërkesë tek të gjithë Sekretarët e Ministrive nga koordinatorja e grupit të dytë për identifikimin e fushave të kontraktimit të shërbimeve për OSHC nga ana e Qeverisë, si dhe publikimin e fondeve për dy vitet e fundit që ministritë kanë ndarë për organizata të shoqërisë civile. Vetëm dy ministri i kanë dërguar nga një listë të pa kompletuar me informata rreth ndarjes së granteve për OSHC. Në tetor 2016 ZQM ridërgon kërkesën tek ministritë për publikim të fondeve publike. Ende ka mungesë të vullnetit nga ana e Qeverisë në krijimin e mekanizmit transparent përmes Zyrës së Thesarit, ku të gjitha fondet e ndara për shoqëri civile do të identifikoheshin shumë lehtë. Po ashtu listat e publikuara të organizatave të mbështetura me grante nga ministritë nuk janë të mjaftueshme, pasi mungojnë informatat si projektet e realizuara, rezultatet e projekteve etj.

Shembuj të tjerë janë vonesa në fillimin e Ligjit për Filantropi, krijimin e mekanizmit të bashkëfinancimit automatik të projekteve të Be-së nga ana e Qeverisë etj.

Mos funksionalizimi i grupeve ndër-sektoriale të punës - Në kuadër të planit të veprimit të Strategjisë për vitin 2015 dhe 2016 për objektiven strategjike II dhe IV janë paraparë të themelohen dy grupe ndër-sektoriale që do të ndihmojnë në implementim të objektivave strategjike II dhe IV .

Ekipi i Përbashkët i Punës për Përcaktimin e Standardeve dhe Parimeve për Kontraktim të Shërbimeve Publike për OSHC - Me 28.05.2016 me vendim të Qeverisë është emëruar ekipi i përbashkët i punës për Përcaktimin e Standardeve dhe Parimeve për Kontraktim të Shërbimeve Publike për OSHC. Ekipi përbëhej nga 23 anëtarë nga qeveria dhe shoqëria civile. Grupi ka mbajtur vetëm një takim në Tetor 2015. Nga 23 Nëntori 2015 një anëtar i shoqërisë civile ka dhënë dorëheqje nga Këshilli për arsye personale. Edhe pse janë zëvendësuar anëtarët e Këshillit nga shoqëria civile grupi nuk ka zhvilluar asnjë takim të rregullt gjatë 2016.

Ekipi i Përbashkët i Punës për Zhvillimin e Vullnetarizmit - Me planin e veprimit të Strategjisë për vitin 2015 është përcaktuar edhe themelimi i Ekipit të Përbashkët të Punës për Zhvillimin e Vullnetarizmit. Ky grup me vendim të Qeverisë është themeluar me 13 Nëntor 2015. Përzgjedhja e anëtarëve të shoqërisë civile është bërë në koordinim me koordinatorin dhe anëtarët e grupit të IV-të, ndërsa anëtarët e qeverisë janë emëruar me vendim të drejtpërdrejt . Sipas vendimit ekipi është i përbërë nga 28 anëtarë nga shoqëria civile dhe qeveria. Është organizuar një takim informues në zyrat e Qeverisë para vendimit të themelimit të grupit. Pas takimit informues grupi nuk ka mbajtur asnjë takim deri më tani.

REKOMANDIMET KRYESORE

Rekomandim 1: Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM) urgjentisht duhet të rris kapacitetet e brendshme me resurse njerëzore, dhe së paku dy deri në tre nëpunës civil me kohë të plotë të jenë emëruar vetëm për procesin e bashkëpunimit shoqëri civile-qeveri, respektivisht për zbatimin e Strategjisë Qeveritare.

Rekomandim 2: Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të ndajë buxhetin e paraparë me plan të punës së Strategjisë për implementimin e veprimeve që kërkojnë kosto financiare.

Rekomandim 3: Anëtarët e Këshillit nga Qeveria të emëruar në Këshill të marrin pjesë në takime të Këshillit dhe grupeve të punës, ose të sigurohen që pikat e kontaktit të jenë zyrtar të kyçur në proces, duke lehtësuar procesin e vendimmarrjes.

Rekomandim 4: Të ngritët cilësia e monitorimit dhe raportimit për të pasur një pasqyrë më të qartë të zbatimit të Strategjisë.

Rekomandim 5: Të funksionalizohen grupet ndër-sektoriale të punës për objektiven e dytë dhe katërt, sipas mandatit.

Rekomandim 6: Ministrinë të koordinojnë veprimet e tyre me Strategjinë Qeveritare.

Rekomandim 7- Azhurnim i rregullt i webfaqes së ZQM me raporte dhe informacione në lidhje me zhvillimet e fundit, përfshirë këtu edhe gjuhët zyrtare.

VI. ZBATIMI I STRATEGJISË QEVERTARE PËR KATËR OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Objektivi Strategjik I: Pjesëmarrje e siguruar dhe e fuqizuar e shoqërisë civile në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit.

Fuqizimi i pjesëmarrjes së shoqërisë civile në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit është baza e objektivit të parë të Strategjisë. Në Rregulloren e Punës së Qeverisë të miratuar me 25.08.2011 ku përcaktohen rregullat dhe procedurat për hartimin e legjislacionit, si dhe rekomandimeve të politikave nga Qeveria dhe ministritë, për herë të parë me këtë Rregullore përcaktohet edhe organizimi i konsultimit publik për dokumentet qeveritare. Pas hyrjes në fuqi të kësaj rregullore është nxjerrë edhe Udhëzuesi për Procesin e Konsultimit Publik i cili është punuar në bashkëpunim në mes të Zyrës Ligjore të Zyrës së Kryeministrit dhe Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile. Edhe pas avancimit të legjislacionit për procesin e konsultimit publik është parë e pa mjaftueshme pjesëmarrja e shoqërisë civile në procesin e konsultimit publik, vetëm në periudhën 15 ditore me shkrim. Nga viti 2012 Sekretariati i Platformës CiviKos bënë shpërndarjen e dokumenteve qeveritare tek organizatat anëtare duke i inkurajuar për pjesëmarrje në konsultimin publik. Nga raportet e monitorimit që CiviKos ka përgatitur për procesin e konsultimit publik del që konsultimi me shkrim nuk është forma më e mirë e përfshirjes së shoqërisë civile në procesin e konsultimit publik. Hartimi dhe përcaktimi i Standardeve Minimale për procesin e konsultimit publik, ku shoqëria civile dhe publiku i gjerë do të përfshihej në procesin e konsultimit publik qysh në fazat e para të hartimit të dokumenteve qeveritare, është ndër bazat e këtij objektivi Strategjik.

Hartimi i Rregullores për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik - Procesi i hartimit të kësaj rregullore ka qenë proces gjithëpërfshirës në mes shoqërisë civile, dhe Qeverisë së Kosovës. Zyra Ligjore nga Zyra e Kryeministrit, së bashku me ZQM kanë qenë bartëse të hartimit të kësaj rregullore. Baza e hartimit të rregullores është ndërtuar nga dokumenti Propozim i Politikave mbi Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik që është hartuar nga KCSF, dhe është dorëzuar tek ZKM në Mars 2016. Duke filluar nga Muaji Prill 2016 ZL/ZKM së bashku me ZQM, dhe CiviKos dhe me përkrahje të GIZ kanë organizuar një seri të punëtorive për hartimin e Rregullores. Përveç anëtarëve të grupit të I-rë të Strategjisë Qeveritare, në grupe punuese kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të ndryshëm të shoqërisë civile, si dhe përfaqësues nga organizatat ndërkombëtare.

Në Planin e punës për vitin 2015 është paraparë miratimi i kësaj rregulloreje, organizimi i trajnimeve për nëpunës civilë dhe futja në funksion të Platformës online për konsultimin publik. Të gjitha këto aktivitete janë shtyrë për vitin 2016, ku disa prej veprimeve janë ende në proces.

Rregullorja është miratuar nga Qeveria e Kosovës me 29 Prill 2016. Aktualisht me ndihëm e projektit të Asistencës Teknike për Qeverinë janë duke u organizuar trajnime me nëpunës civilë të Qeverisë së Kosovës për përdorimin e kësaj rregullore, derisa KCSF nga Nëntori do të filloj me trajnime për përfaqësues të shoqërisë civile.

Platforma online për procesin e konsultimit publik, në të cilën organizatat do të regjistrohen për të shprehur interesin e tyre në procesin e konsultimit publik dhe të gjitha dokumentet qeveritare për

konsultim publik do të postohen aty, është duke u zhvilluar me ndihmën e projektit të asistencës teknike të BE-së, ku së shpejti pritet funksionalizimi i saj.

Objektivi Strategjik II - Sistem i ndërtuar i kontraktimit të shërbimeve publike për organizatat e shoqërisë civile

Organizatat e shoqërisë civile në Kosovë janë duke vazhduar të japin një numër të madh të shërbimeve që nuk mbulohen nga institucionet shtetërore fare, ose këto shërbime i janë deleguar organizatave të shoqërisë civile. Kryesisht në Kosovë organizatat e shoqërisë civile japin shërbime në fushat sociale si shërbime për personat me nevoja të veçanta, shërbime për gratë viktime të dhunës në familje, për fëmijët jetim etj. Po ashtu ka një numër të madh të organizatave që japin shërbime në fushën e arsimit, shëndetësisë, drejtësisë etj. Nuk dihet saktësisht lloji i shërbimeve që organizatat kontrahohen nga qeveria. Në kuadër të kësaj objektivë është paraparë të krijohet një sistem i qëndrueshëm dhe i pavarur i kontraktimit të shërbimeve për OCHC-të nga ana e qeverisë. Për të parë llojet e shërbimeve që OSHC-të janë kontraktuar nga Qeveria deri më tani, është dërguar një kërkesë e veçantë nga koordinatori dhe grupit të II-të të punës, ku kërkohet lista e OSHC-ve të kontraktuar në dy vitet e fundit si dhe fusha e kontraktimit. Po ashtu kjo kërkesë është përcjellë edhe nga ana e ZQM gjatë muajit Tetor 2016. Deri më tani asnjë ministri nuk ka ofruar ndonjë listë të organizatave që i kanë kontraktuar dhe llojin e shërbimeve që organizatat kanë ofruar për qeverinë.

Objektiva e II-të e Strategjisë ka më së shumti ngecje në implementim. Në maj 2015 me vendim të Qeverisë emërohet Grupi i Përbashkët për Ndërtimin e Sistemit për Kontraktim të Shërbimeve Publike nga OSHC-të i cili grup themelohet për përcaktimin e standardeve dhe parimeve për kontraktim të shërbimeve publike nga OSHC-të. Grupi është i përbërë nga anëtarë të Këshillit nga shoqëria civile dhe Qeveria. Grupi është takuar vetëm një herë në Tetor të viti 2015 ku është diskutuar kryesisht rreth plotësim ndryshimit të ligjit për Prokurim Publik, ku është vendosur edhe neni për kontraktim të shërbimeve nga ana e OSHC-ve , dhe certifikata e regjistrimit të OJQ-ve pranohet në procesin prokurimit publik.

Sfidë në implementim të kësaj objektivë s ka qenë mungesa e angazhimit, dhe ekspertizës së anëtareve të shoqërisë civile dhe qeverisë në grup punues, largimi nga Këshilli i dy anëtarëve të shoqërisë civile për arsye personale etj

Disa nga sfidat për këtë objektivë janë:

- Mungesë e koordinimit të ministrive mes vete sa i përket kontraktimit të shërbimeve.
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale bënë licencimin e organizatave që ofrojnë shërbime sociale, por nuk ka koordinim me Strategjinë Qeveritare.
- Mungesë e buxhetit për analizat e parapara nga Qeveria .
- Mbështetja vetëm në analizat për llojin e shërbimeve që kontrahohen nga OSHC-të që është duke u realizuar nga projekti i asistencës teknike.
- Trupa e përbashkët për Ndërtimin e Sistemit për Kontraktim të Shërbimeve Publike nga OSHC-të nuk ka funksionuar në mënyrë të rregullt.

- Largimi i disa anëtarëve të shoqërisë civile që kanë qenë pjesë e grupit.

Objektivi Strategjik III - Sistemi i ndërtuar dhe kritere të përcaktuara për përkrahje financiare për OSHC-të

Qysh nga pas lufta në Kosovë organizatat e shoqërisë civile në Kosovë kryesisht mbështeten financiarisht nga donatorët e huaj. Një numër i organizatave të shoqërisë civile kanë arritur të rrisin kapacitetet e tyre dhe të krijojnë qëndrueshmëri duke krijuar shërbime të vetë-qëndrueshme, deri sa edhe në ditët e sodit një numër i madh i organizatave mbeten të varura nga donacionet e huaja. Nga Indeksi i shoqërisë civile për vitin 2014³ 74.0 % e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë mbështeten financiarisht nga donatorët e huaj. Sipas këtij studimi institucionet qendrore dhe lokale sigurojnë 20.5 % të fondeve të shoqërisë civile në Kosovë. Edhe pse shumicën e punës së tyre organizatat e shoqërisë civile e ofrojnë në mënyrë vullnetare, qëndrueshmëria financiare për funksionim të vazhdueshëm në ofrim të shërbimeve të tyre është shumë i rëndësishëm. Objektiva e III-të e Strategjisë ka për synim krijimin e një sistemi transparent të përkrahjes financiare për shoqërinë civile nga fondet publike, me mekanizma të qartë të raportimit dhe mbikëqyrjes.

Përcaktimi i modelit të Skemës Nacionale të granteve për shoqëri civile- Me Planin e punës për 2015 ka qenë e paraparë përcaktimi i modelit të skemës së granteve. Me mbështetje të TACSO në Kosovë dhe në bashkëpunim me ZQM, dhe Ministrinë e Financave në Maj është organizuar punëtorja e parë për përcaktimin e modelit të Skemës Nacionale të granteve për shoqëri civile. Në Dhjetor 2015 në punëtorinë e dytë janë vendosur bazat e modelit të përzier të financimit të OSHC-ve. Aktivitete që nuk janë realizuar gjatë 2015 janë bartur për vitin 2016. Në Prill 2016 Këshilli miraton modelin e përzier të përkrahjes financiare të shoqërisë civile nga fondet publike, ndërsa Qeveria e Kosovës miraton këtë model me 25 Maj 2016. Në Shtator 2016 është formuar grupi për hartimin e Rregullores për Standardet Minimale me vendim të Qeverisë, ndërsa me 30 Shtator është mbajtur punëtorja e parë e grupit, ku takimet e grupit janë duke vazhduar.

Vendimi për bashkëfinancimin automatik të projekteve të OSHC-ve që financohen nga BE (sipas përqindjes së përcaktuar nga BE) - Mekanizmi për bashkëfinancimin automatik të organizatave që marrin grante nga Komisioni Evropian sipas përqindjes së përcaktuar nga BE do të krijojë lehtësira tek organizatat e shoqërisë civile të cilat fitojnë grante nga Komisioni Evropian, e që kusht është bashkëfinancimi. Shpesh herë organizatat e kanë të vështirë sigurimin e bashkëfinancimit për projektet e tyre. Duke marrë parasysh vështirësitë e sigurimit të bashkëfinancimit nga organizatat e shoqërisë civile është paraparë krijimi i një sistemi, ku Qeveria e Kosovës do të bashkë-financoj në mënyrë automatike të gjitha organizatat që përfitojnë grante nga Komisioni Evropian. Ky veprim ka qenë i paraparë me plan të punës për vitin 2015, i cili veprim nuk është realizuar. Po ashtu në planin e punës për 2016 është futur si veprim, që deri më tani nuk ka një konsensus në mes Ministrive për të marrë përsipër implementimin e këtij veprimi .

³ <https://zqm.rks-gov.net/Portals/0/RAPORTI%20-%20I%20FUNDIT%20%20JANAR%20%202016.pdf>
http://www.kcsfoundation.org/repository/docs/14_04_2014_2142029_Indeksi_Kosovar_i_Shoqerise_Civile_shqip_web.pdf

Hapja e Forumit të Donatorëve për pjesëmarrje të shoqërisë civile dhe hapja e bazës së të dhënave të donatorëve për shfrytëzim nga shoqëria civile - Ministria e Integritit Evropian si bartëse e këtyre veprimeve gjatë vitit 2015 me ndihmën e Sekretariati të CiviKos kanë organizuar një trajnim një ditorë me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile rreth shfrytëzimit të bazës së të dhënave të donatorëve. Pas përfundimit të trajnimit rreth shfrytëzimit të këtij mekanizimi të gjithë pjesëmarrësit janë pajisur edhe me llogari ku në të ardhmen do të kenë qasje në këtë bazë të dhënave.

Hapja e forumit të donatorëve për pjesëmarrje nga shoqëria civile, si veprim i paraparë me planin e punës për 2015 dhe 2016 nuk është realizuar deri më tani.

- Sfidat në implementim të kësaj objektive:
- Mungesa e analizave të legjislacionit ekzistues nga Qeveria për zbatimin e përbashkët të projekteve.
- Mos koordinim mes Ministrive për hartimin e ligjit për Filantropi, edhe pse me plan të punës për 2015 institucion përgjegjës ka qenë Ministria e Financave ndërsa në planin e punës për 2016 institucion përgjegjës është Zyra Ligjore e Zyrës së Kryeministrit.
- Mungesë e transparencës në ndarjen e fondeve publike për OSHC - Kërkesë e vazhdueshme e Këshillit dhe shoqërisë civile në publikimin e fondeve publike për shoqëri civile. Vetëm në Tetor 2016 ZQM dërgon kërkesën tek Sekretarët për publikimin e fondeve të ndara për shoqëri civile.
- Mungesë e vullnetit dhe mos koordinim i ministrive në krijimin e sistemit për bashkëfinancimin automatik të OSHC-ve përfituese të granteve të BE-së (veprim i paraparë në planin e punës për 2015 dhe 2016)
- Mungesë e analizave që rregullon mënyrën e përkrahjes jo-financiare.

Objektivi Strategjik IV - Nxitja e Qasjes së Integruar në Zhvillimin e Vullnetarizmit

Vullnetarizmi është praktika e njerëzve të cilët punojnë dhe angazhohen në veprimtari të caktuara, që janë në dobi të përgjithshme të shoqërisë, pa qenë të motivuar financiarisht. Përveç përfitimit ekonomik që sjellë puna vullnetare, ajo ndihmon në ngritjen e aktivizimit qytetar në të mirë të përgjithshme. Vullnetarizmi aktualisht është një fushë e nën-rregulluar me legjislacionin dhe politikat shtetërore të Kosovës. Ligji për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë trajton në mënyrë të përgjithshme vullnetarizmin tek të rinjtë, ndërsa atë e përkufizon si “Veprimtari e rinisë e organizuar nga institucioni përkatës, ku të rinjtë vullnetarisht ofrojnë kohën, punën, njohuritë, aftësitë e tyre pa pagesë apo shpërblim, në shërbim të komunitetit, për të mirën e shoqërisë”. Ky ligj kufizohet në trajtimin e vullnetarizmit vetëm në moshën 15 – 24 vjeç, duke e lënë të patrajtuar pjesën tjetër të shoqërisë e cila ka një potencial të madh të punës vullnetare. Duke marrë parasysh diversitetin shoqëror kjo objektivë e Strategjisë Qeveritare synon që fillimisht të analizohet dhe të identifikohen nevojat dhe profili i punës vullnetare në Kosovë, dhe varësisht nga kjo të zhvillohet debati dhe ndërtohet sistemi më adekuat për nevojat specifike të Kosovës.

Në Planin e punës për vitin 2015 të Strategjisë ishin paraparë të realizohen pesë analiza si: Analizimi i profilit të vullnetarit në Kosovë, Analizimi i legjislacionit që prekin vullnetarizmin, Analizimi i sektorit të shoqërisë civile (shembujt e suksesit dhe mësimet e mësuara), Analizimi i përvojave ndërkombëtare

(rastet studimore) dhe Analizimi i motivimit të vullnetarizmit ne Kosove. Në mungesë të buxhetit të ndarë nga Qeveria e Kosovës, asnjëra nga këto analiza nuk u realizua gjatë vitit 2015. Këto analiza janë bartur në planin e punës për 2016.

Edhe në Planin e Punës për vitin 2016 janë përfshirë pesë analiza, si dhe buxheti i paraparë nga Qeveria për realizimin e këtyre analizave. Deri më tani ZQM si bartëse e këtyre veprimeve nuk ka ndarë buxhet për realizim, derisa vetëm dy nga këto analiza janë duke u realizuar nga projekti i asistencës teknike të Be-së.

Disa nga Sfidat në implementim të kësaj objektive:

- Nuk është zhvilluar asnjë takim për Funkcionalizimin e grupit ndër-sektorial për vullnetarizëm. Ky grup është themeluar me vendim të Qeverisë me datë 13.11.2015.
- Nuk është ndarë buxhet nga Qeveria e Kosovës për realizimin e analizave të parapara me planin e punës për vitin 2015-2016.
- Mos harmonizim në mes të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, dhe nxjerrja e Udhëzimit Administrativ për vullnetarizëm pa u koordinuar me veprimet e Strategjisë Qeveritare.

VII. SHTOJCAT

Shtojca-1 Buxheti i nevojshëm për realizimin e Planit të Punës për vitin 2015, dhe 2016 sipas katër objektivave.

2015	<p>Për realizimin e planit të punës për vitin 2015 janë paraparë gjithsej 287.000 euro ku:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Për Objektiven I-rë- 145.000 euro, • Për Objektiven e II-të-35.000 euro, • Për Objektiven e III-të- 40.000 euro, dhe • Për Objektiven e IV-të-67.000 euro.
2016	<p>Për realizimin e planit të punës për vitin 2016 është paraparë buxhet prej 249.300 euro ku :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Për Objektiven e I-rë 86.000 euro, • Objektiven e II-të 32.300 euro, • Objektiven e III-të 78.000 Euro, dhe <p>Objektiven e IV-të 53.000 euro</p>

Shtojca 2- Obligimet e ZQM sipas vendimit të Qeverisë të datës 28.10.2014 për themelimin e Këshillit

- 1) ZKM/ZQM do të shërbejë si Sekretarit dhe do të jetë organi përgjegjës për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të Strategjisë qeveritare dhe Planit të Veprimit.
- 2) Për funksionimin pa pengesa të gjitha detyrat administrative dhe teknike do të kryhen nga ZQM
- 3) ZKM/ZQM obligohet që në baza vjetore të publikoj Raportin për zbatimin e Strategjisë dhe Planit

të Veprimit.

- 4) Përveç raporteve të përgatitura nga Zyra Për Qeverisje të Mirë, Këshilli do ti marrë parasysh edhe do ti diskutoj edhe raportet tjera të monitorimit paralel që mund të përgatiten nga Platforma CiviKos dhe OSHC tjera.
- 5) Për mbarëvajtjen me sukses të punës së këtij Këshilli, Sekretariati do të mbështetet nga Zyra e Kryeministrit financiarisht dhe me resurse njerëzore.
- 6) Platforma CiviKos dhe organizatat tjera të interesuara do të jenë të ftuara që në baza të rregullta të monitorojnë dhe raportojnë paralelisht rreth zbatimit të aktiviteteve konkrete të parapara me këtë Strategji.
- 7) Për mbarëvajtjen dhe për një punë të suksesshme të këtij Këshilli, Sekretariati do të mbështetet nga Zyra e Kryeministrit qoftë financiarisht qoftë edhe me resurse njerëzore.

Shtojca 3- Përbërja e Zyrës për Qeverisje të Mirë

Zyra për Qeverisje të Mirë ka gjithsej të punësuar 8 nëpunës civil me këtë përbërje:

- 3.1. Drejtor i Zyrës për Qeverisje të Mirë;
- 3.2. Koordinator i Zyrës për Qeverisje të Mirë ;
- 3.3. Zyrtar i lartë për të drejta të fëmijëve;
- 3.4. Zyrtar i lartë për Qeverisje të Mirë;
- 3.5. Zyrtar i lartë për mundësi të barabarta dhe aftësi të kufizuara;
- 3.6. Zyrtar i lartë për mundësi të barabarta dhe minoritete;
- 3.7. Zyrtar i lartë për antidiskriminim;
- 3.8. Asistent Administrativ.